



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 723/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Vedat Poterqoi- Anëtar dhe Agon Ramadani- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Agrium Sh.P.K & Ekotech Group Sh.P.K" në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe rregullimi i vendeve të kontinjerëve" me numër të prokurimit: 612-22-8560-1-1-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 01.02.2023, mori:

V E N D I M

1. Vërtetohet, Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit i datës 22. 08. 2022, i Komunës së Prishtinës nga cilësia e Autoritetit Kontraktues, për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe rregullimi i vendeve të kontinjerëve" me numër të prokurimit: 612-22-8560-1-1-1;
2. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore për OE ankues "Agrium Sh.P.K & Ekotech Group Sh.P.K" Ferizaj, i cili duhet të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sikurse parashihet me nenin 31 pika 6 të Rregullores për punën e OSHP;

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.08.2022 Komuna e Prishtinës, duke vepruar nga cilësia e sajë si Autoritet Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe rregullimi i vendeve të kontinjerëve" me numër të prokurimit: 612-22-8560-1-1-1.

Me 14.11.2022, OE "Agrium Sh.P.K & Ekotech Group Sh.P.K" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me vendimin e AK të datës 21.11.2022.

Me 31.11.2022 OE "Agrium Sh.P.K & Ekotech Group Sh.P.K" ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 723/2022, kundër Njoftimit të cituar si më sipër, përkitazi me vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, sikurse parashihet me nenin 17 të Rregullores së punës të OSHP, Paneli Shqyrtues konstatoi se: Ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij Ligji. Parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26 dhe nuk ekzistojnë elementet e konfliktit të interesit sipas nenit 4, paragrafi 1.75 lidhur me nenin 11 të Rregullores së cituar. Meqë ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e OSHP në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 lidhur me nenin 114 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, ekspertin vlerësues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit, me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës;

Raporti i vlerësimit është pranuar nga të dyja palët, me ç'rast Ankuesi ka deklaruar se pajtohet me disa konstatimet e ekspertit ndërsa AK nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues. Në vijim, Paneli konstatoi se palët disponojnë në kopje identike me të gjitha shkresat e lësaj lënde dhe se ka kushte të hapet procedura e administrimit dhe vlerësimit të provave.

- Administrimi dhe lërësimi i provave -

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë (datë 19 janar 2023), sikurse parashihet me nenin 24.2, të Rregullores për punën e OSHP për vlerësimin objektiv të provave dhe pohimeve ankimore dhe për të vendosur drejtë në aspektin meritore. Paneli konstatoi në vijim se:

- AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit, ka zbatuar Kontratë Publike Kornizë - Furnizim, kurse vlera e parashikuar e kontratës është: 600,000.00 €;
- Kurse Ankuesi, ka atakuar me ankesë vendimin e cituar si më sipër të AK për dhënie të kontratës, duke pohuar në ankesë dhe gjatë seancës së shqyrtimit publik se i plotëson kriteret lidhur me specifikacionet teknike të produkteve, kurse AK e ka shpërblyer me kontratë një OE të pa papërgjegjshëm i cili nuk i plotëson as kriteret profesionale dhe ekonomike të parashtruar në DT.

AK ka shpjeguar se aktiviteti prokurimit në rastin konkret përfshinë një vlerë të konsiderueshme e cila e ka detyruar të veproj me kujdesin e shtuar, përfshirë dhe monitorimin e vazhdueshëm nga mediumet dhe OJQ e ndryshme. AK ka shpjeguar në vijim se, ka pranuar gjithënjë 3/tri oferta, ka realizuar shikim në vend të mostrave për artikujt e ofruar (kontejnerët) nga OE, duke shpërblyer OE me të lire dhe me artikujt e ofruar konform DT, përderisa artikujt e ankuesit nuk i kanë plotësuar kriteret dhe/ose specifikat e kërkuara. Për shkak të natyrës kontestuese të çështjes, Paneli shqyrtues e konsideroi të nevojshme të aplikohet super-ekspertiza për sigurimin e informatave dhe provave plotësuese në raport me pretendimet reciproke të palëve. Lidhur me këtë OSHP me 19.01.2023, ka caktuar në cilësinë e ekspertit një inxhinier të makinerisë, i cili e ka dorëzuar Raportin e vlerësimit 27.01.2023, me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pa bazuar;
- Kurse vendimi i AK të mbetet në fuqi;

Paneli konsiderron se Raporti i superekspertizës, i plotëson elementet qenësore të një dokumenti të tillë, sikurse kërkohet me nenin 114 të LPP, sipas të cilit konstatohet se Eksperti ka ndërmarrë një serë veprimesh, ka analizuar në superekspertizë në mënyrë të detajuar dhe të argumentuar faktet dhe arsyet e eliminimit të ankuesit, ka verifikuar mostrat në raport me kërkesat dhe specifikave teknike të vendosura në Dosjen e Tenderit duke i analizuar në raport me pretendimet kryesore të ankuesit, sipas të cilit AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderit sepse pa arsye bindëse dhe të faktuara e ka eliminuar Ankuesin se gjoja se mostrat nuk i plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në dosjen e tenderit. Në fakt, Paneli vëren se sipas superekspertizës konstatohet (shkurtimisht si në vijim) se: Dimensionet e artikullit të kërkuar (kontejnerëve) nuk përputhen me dimensionet e specifikuara në DT. Sipas fig. së prezantuar nga ana e eksperti shqyrtues fq. 11, thekson se OE ka vendosur forma tjera në profilet e mekanizmit për hapjen e kapakut, pjesa leva me numër 3 siç është e precizuar me vizatimit teknik dhe që shërben për përforcim të pjesëve anësore ashtu që kontejneri të ketë qëndrueshmëri më të gjatë. OE nuk e ka vendosur këtë përforcim që dashur gjithsesi të vendoset tek dy anësore e produktit siç është paraqitur në vizatimin teknik. Mbrojtja nga korrozioni nuk i përgjigjet specifikimit teknik sipas EN-1461 dhe se pastërtia e zinkut nuk i plotëson kërkesat e parapara për 99,99%. Më tej, në raport theksohet se pas shikimit të mostrës korrozioni është shfaqur në disa pjesë të kontejnerit gjë që procesi i galvanizimit nuk është kryer në përputhje me standardin e kërkuar. Më tej thuhet se,

doreza e kapakut nuk është në harmoni me standardin EN 840-6:2020, pjesët anësore nuk janë salduar dhe nuk janë puthitur, vërehet një saldim jo profesional e tjerë, të konstuara me rastin e shikimit në vend me 24.01.2023.

Paneli shqyrtues, pas analizimit të gjithmbarshëm të shkresave të kësaj lënde dhe provave të siguruara, të cilat janë administruar dhe analizuar në tërësi në raport me pretendimet ankimore, konstatoi shkurtimisht sikurse vijon:

- Raporti i superkekspertizës konsiston në një dokument profesional, i cili karakterizohet me prova bindëse dhe jo kontestuese me çrast rekomandimet e superkekspertizës janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.
- AK, ka vepruar në harmoni me nenin 6, 7 dhe nenin 27 dhe 28 dhe në harmoni me nenin 52, 54, 59 dhe 60 të LPP prandaj vendimi i AK duhet të mbetet në fuqi dhe se ankesa në rastin konkret nuk është e bazuar.

Paneli shqyrtues ka konstatuar se AK ka zhvilluar këtë aktivitet të prokurimit në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse nga ekzaminimi dhe vlerësimi në teren, vërehet se AK me të drejtë ka eliminuar OE ankues, përderisa kontinijerët e kërkuar nuk janë sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Vendimi për pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi, është marrë duke u bazuar në faktin se AK në vendimin për rishqyrtim ndaj kërkesës së ankuesit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 108 pika 9 të LPP cituar ; Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtuesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë, PSH sqaron se tek vendimi i AK për refuzim i njëjti ka përshkruar vetëm se OE nuk i ka plotësuar specifikat teknike duke mos specifikuar se cilat specifika nuk i ka plotësuar, andaj vlerëson se kjo ka ndikur ankuesi të drejtohet Organit Shqyrtues të Prokurimit, Kurse lidhur me këto veprime të AK precizuar më sipër, Paneli Shqyrtues, përmes këtij vendimi lëshon vërejtje ndaj AK, duke theksuar se në rast se evidentohen në të ardhmën shkelje të caktuara dhe të përsëritura të tilla ose të ngjashme, OSHP do të kërkojë nga KRPP që të ndërmarr masa konform nenin 25 të LPP.

Prandaj bazuar në të lartëcekurat, Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK-Kuvendi Komunal Prishtinë
- OE Ankues
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb- faqe të OSHP